

Etika për fëmijë

Dhuratë e përmuajshme, nga revista "Etika"

Viti I Numri 3 - Mars 2011

Lexo...





Të kesh një ideal të mirë në jetë!

Të dashur fëmijë, selamun alejkum!

Çdo njeri ka një ideal. Por ka dhe plot dëshira, plot ëndrra, për të cilat përpiqet, lufton dhe kërkon t'i realizojë në jetë.

Ndodh dhe kështu...

Një vajzë e re thoshte se kishte hequr dorë nga ushqimet e saj të preferuara, pasi donte të mbante trupin në formë. Kur e pyesnin se si mund t'u rezistonte ëmbëlsirave dhe pastave, ajo përgjigjej: "Dobësimi është ideali im më i madh. Vetëm një herë në javë i jap të drejtë vetes të ha dy copëza të vogla ëmbëlsira. Ndërsa, në ditët e tjera, as që bëhet fjalë. Natyrisht, nuk është e lehtë. Më duhet t'ia dal mbanë duke i dhënë kurajo vetes: Ndall!, të gjitha ushqimeve që më thonë t'i ha! Ndonëse secili ushqim më thotë: 'Merrmë edhe mua për të më ngrënë!'

Duhet të përpiqem fort, të kem vullnet të madh, ndryshe do të humb idealin..."

Ndodh dhe kështu...

Një fëmijë 13 vjeçar kishte zënë merak në sportin e xhudos. Ideali i tij më i madh ishte të shkonte në Kinë. Dëshironte të bëhej një xhuidist kampion. Duke shkuar në atë vend të largët, donte të gjente patjetër mësuesin-mjeshtër më të mirë. Për këtë arsye, fëmija ditë e natë merrej me mësimet e xhudos, kursente e grumbullonte paratë e duhura për të realizuar idealin e tij.

Ndodh dhe kështu...

Një mësuese e gjuhës angleze tregonte se në fëmijërinë e saj kishte pasur shumë dëshirë të falte namazin. Mirëpo familjarët e saj nuk kishin njohuri për Islamin. Me sa kisha mësuar nga mësimet fetare dhe shoqëria ime, marrja e abdesit, veshja e robave për namaz dhe drejtimi përpara Krijuesit të gjithësisë më jepnin një qetësi dhe lumturi të madhe. Nëna nuk i pëlqente këto gjëra dhe më thoshte se, nuk ishte e nevojshme t'i bëja. Jam përballur me sa e sa fyerje dhe presione. Por nuk tërhiqesha. Namazin e falja vazhdimisht, por fshehurazi. Kur e falja, më jepte një tjetër kënaqësi. Një ditë, nëna u gjend para një të papriture që, as vetë nuk arrija ta kuptoja. Tek ajo diçka kishte ndryshuar... Më pas, më tregoi se kishte parë në ëndërr, një dorë të fuqishme që e godiste atë duke i thënë "Mos i ndërhyj më vajzës tënde! Ajo ka një ideal!" Kur ishte ngritur, mbante me dorë njërin krah dhe thoshte se e ndjente ende dhimbjen. Që në atë

çast, nëna nisi të më ndiqte me qetësi dhe habi. Po respektonte idealin tim.

Të dashur fëmijë!

Qëllimi duhet të jetë i atillë që, të na lartësojë edhe në këtë jetë edhe në botën tjetër. Duhet të na çojë pranë Pejgamberit tonë, nën flamurin e tij... Ja pra, ky është edhe ideali më i lartë... Të mbash mbi çdo gjë urdhërin e Zotit, t'i jetosh dhe t'i vësh ato në jetë. Pejgamberi ynë na paraqitet vetë me shembullin më të mirë në këtë drejtim. Transmetimi i urdhërave dhe i parimeve të Allahut të Lartëmadhëruar, shpjegimi i tyre, lumturia e njeriut dhe të qëndruarit e tij larg të këqijave, ishte ideali i Tij më i madh. Ai që i vetëdijshëm edhe për shumë vuajtje që do përjetonte gjatë kësaj rruge, si: sulmet me gurë, plagët e rënda aq sa pikat e gjakut i binin deri në këpucë, e sa e sa vuajtje të tjera, vetëm e vetëm për të realizuar idealin e Tij. Ai, gjithmonë, shpresonte tek ndihma e Allahut të Lartëmadhëruar.

Të dashur fëmijë!

Çdo njeri duhet të ketë një ideal, një qëllim, një dëshirë. Çdo ditë duhet ta ëndërrojë atë. Ditë e natë duhet të jetë me të. Ideali i Pejgamberit tonë duhet të jetë edhe i yni, qëllimi i Tij duhet të jetë edhe yni, dëshira e tij duhet të jetë edhe dëshira jonë. Jepuni përparësi para së gjithash urdhërave të Zotit, jetojini dhe përjetojini ato... Ju do pyesni: "Po pengesat që dalin përpara?..." Ato janë të përhershme. Por ideali, qëllimi dhe dëshirat i mundin ato, dhe ti, i dashur fëmijë del fitimtar. Po, po fitimtar!..

Të dashur fëmijë, mos harroni, se çdo gjë e bukur që jetoni, megjithë pengesat që mund të keni, të cilat i kapërceni patjetër, ju shton më shumë vlera dhe ju lartëson përpara Allahut. Ata që kanë njohuri e dinë mirë se, afërsia me Allahun i jep njeriut një kënaqësi të pallogaritshme.

Të dashur fëmijë, sa të lumtur janë ata që kanë pëlqyer si ideal të tyre arritjen e lumturisë së dy botëve... Sa të lumtur janë ata që për hir të idealeve dhe qëllimeve të tyre i kalojnë pengesat që u dalin përpara.. Sa të lumtur janë ata që jetojnë më dëshirën për të qenë së bashku me Krijuesin e gjithësisë...

Ju lë amanet te Zoti, miqtë e mi të vegjël, të mirë e të ngushtë!

Kurani Gjigant

Eris Bushati

Dikur, diku, në një qytet të lashtë (s'e di se ku se e vogël jam), na ishte një KURAN gjigant dhe ca njerëz të vegjël.

Mirëpo ç'ndodh në këtë qytet?

S'e merrni me mend!

Njerëzit e vegjël, të mahnitur nga madhështia e këtij libri të mrekullueshëm, çdo ditë lexonin të etur në faqet e tij dhe mrekulloheshin. Aty ku mbeteshin një ditë vazhdonin ditën e mëpastajme.

Dhe kështu çdo ditë, të kënaqur prej tij filluan edhe të luteshin. Vargu i njerëzve ishte i gjatë, i gjatë sa mbështillte gjithë qytetin e njerëzve të vegjël.

Po ç'ndodhte kur vinte mbrëmja?! Njerëzit nuk flinin dot pa lexuar diçka nga rreshtat e tij të ndritur, nuk flinin dot edhe pa bërë lutjen.

Dhe rendnin drejt tij. Fletët e mbyllura ata i quanin "perde" përtej të cilave njihnin të vërtetat e botës dhe dituroheshin. Dhe kështu, secili gjente "perden" e vet, futej brenda e në të plotësonte veten para gjumit dhe të qetë shkonin të flinin.

Dikush tjetër (njeri i madh më duket) çdo mëngjes ngrihej më herët se të tjerët dhe, ashtu siç lante sytë e vet pas gjumit, pastronte dhe kapakun e ndritshëm të KURANIT (që njerëzit e vegjël e quanin derë) për t'i hequr edhe përgjumjen.

Dhe kështu vazhdonte çdo ditë. Sa zgjati kjo nuk e di. Ndoshta vazhdon edhe sot. Kushedi? Por... çudi, çudi!

E dini ç'ndodhi në këtë qytet?

S'e merrni me mend!

Ndodhi çudia.

Sa më shumë njerëzit e vegjël lexonin në faqet e këtij libri të mrekullueshëm, aq më shumë rriteshin. Derisa u bënë njerëz si të gjithë njerëzit.

Ilustrime Eris Bushati

Etika për fëmijë

Viti I Numri: 3 - Mars 2011

Administrator
i Progresi botime:
Shuaip Bashhan
bashan43@hotmail.com
+355 69 20 76768

Drejtor
& Kryeredaktor:
Alban Kali
albankali@yahoo.com
+355 69 24 23 989

Redaktor:
Xhahid Bushati
Redaktore gjuhësore:
Ma. Irida Hoti

Dizajn - Grafik:
Bledar Xama
bledar_xama@hotmail.com

Adresa: L: Vasil Shanto - Rr: Çajupi - Shkodër - Albania / Tel: +355 22 254 634 / Fax: +355 22 254 633
Zyra e përfaqësimit Maqedoni: Rr: Stiv Naumov - Nr. 9 - lokal 25 - Shkup - Maqedoni / Tel: +389 71 956 271
Zyra e përfaqësimit Kosovë: Rr: Ardian Zurnaxhiu - pn. Ralin - Prizren - Kosovë / Tel: +381 29 222 795

Ninulla e nënës...

Ilir Dukagjini

Nata erdhi, erdhi nata.
"Natën..!" - foli, ga-ga, pata.
Dhe e pa e vogla hënë
si u fsheh sqepi nën pendë.

Nata erdhi, erdhi nata.
"Natën..!" - foli, kri-kri, ketri.
Gjeti shpejt një boçe pishe,
aty kokën e mbështeti...

Dhe pa hëna nëpër natë,
bisht i ketrit mbeti jashtë.

Ketrushi të ëndërrojë,
bishti pufkë i bënte rojë...

Nata erdhi, erdhi nata.
"Natën..!" - tha një zog i mitur.
gjeti shpejt puplën e nënës,
fjeti zogu i parritur...

Dhe e pa e vogla hënë
dashuri ka emri Nënë!...

Nata erdhi, dhe një ylli
na i thotë: "Ku shkon, o bir?!"
Vallë si pata, ketri, zogu;
më thua: "Natën e mirë!?"

Buzëqeshi yll i vogël
qjellin ndriti, qjellin lë...
"Mos të thirri xixëllonja?"
"Jo, o natë, ende po fle."

"Mos të thirri yll' i detit,
apo larg ndonjë fener?
Mos vallë pylli të ka ftuar,
yll, o bir, ku shkon, nga bredh?!"

Ec e ec ylli e nata
kalojnë kodra edhe male,
shikon nata, e çuditur,
ylli rri te një dritare...

"Bir, je lodhur, bëj pak gjumë!"
"Po dëgjoj një nina-nani!"
Dhe vërtet dëgjon dhe nata:
"Fli, se yll të ka ty mami!"

Ylli s'priti, u afrua
e në dhomë dritë hodhi,
"Natë moj, Ninullë e Nënës,
që nga larg mua më solli!"

Nata syçkat i puliti
dhe u nis, u nis për udhë,
e shpërndante dritë ylli,
e shpërndante një ninullë...

Fëmija i aftë

Tri gra po ktheheshin nga tregu me shporta në duar. Pasi u ulën për të pushuar diku në një stol në qoshe të rrugës, filluan të bisedojnë për fëmijët e tyre.

Gruaja e parë tha se djali i saj mundte të ecte me minuta të tëra mbi duar.

E dyta, tregoi se djali i saj kishte zë bilbili dhe të gjithë e admironin teksa këndonte.

Ndërsa e treta u mjaftua duke i dëgjuar ato. Dhe kur e pyetën se, përse nuk foli, ajo u tha:

- Djali im nuk ka ndonjë aftësi të veçantë që ta tregoj.

Ndërkohë, që gratë u ngritën për të vazhduar rrugën, një i moshuar, që kishte dëgjuar gjithë bisedën, i ndoqi nga pas.

Në krye të rrugës gratë i ulën shportat e tyre përsëri e filluan të fërkonin krahët e lodhur dhe mesin që u dhimbte. Sapo i panë fëmijët e tyre, erdhën duke vrapuar.

Djali i gruas së parë filloi të ecte mbi duar duke kapërcyer.

Djali i së dytës u ul mbi një gur dhe filloi të këndonte njërën nga këngët që pëlqente nëna e tij.

Të gjitha duartrokitën me plot entuziazëm.

Ndërsa djali i gruas së tretë ia mori shportën nënës së tij duke i thënë:

- Po të ndihmoj nënë e dashur, se je lodhur shumë!


Pastaj gratë e pyetën burrin e moshuar, që po kalonte aty, mbi aftësitë e djemve të tyre.

Ai u tha:

- Unë pashë vetëm një djalë të aftë. Ai ishte djali që vrapoi për të ndihmuar nënën e tij, sepse ai veproi sipas këtij hadithi të Pejgamberit tonë të Nderuar:

**“Të gjithëve ju këshilloj
që ta ndihmoni nënën tuaj!”**





Pjata plastike

Një marangoz ishte plakur shumë. Në sy nuk i kishte ngelur shikim e as në duar fuqi. Ngaqë i dridheshin duart, nuk arrinte ta shmangte derdhjen e ushqimit në mbulesën e tryezës.

I biri dhe nusja e tij zemëroheshin duke menduar se ai nuk tregonte kujdes. E sidomos shqetësoheshin, kur ushqimi i rridhte nga faqet. Derisa një ditë nuk e lejuan të hante më në një tryezë me ta. I bënë një sofër të ulët. Hasani, nipi i tij i vogël, brengosej shumë për gjendjen e gjyshit. Ai, duke ia mbajtur dorën e plakur, mundahej ta ndihmonte të hante ushqimin pa e derdhur.

Një ditë, plakut të gjorë i ra në tokë pjata e ushqimit. Lu thye. Herë vështronte pjatën e thyer, herë vështronte me sy të përbotur njerëzit që po hanin në tryezë. Psherëtinte herë pas here...

Ata u zemëruan shumë me plakun, e fyen me fjalë të rënda. Vendosën që pas kësaj dite ushqimin t'ia jepnin në pjatë plastike.

Një ditë, djali i marangozit plak po i thoshte gruas së tij, të mos i vendoste më frutat në pjata plastike.

- Hidhi këto pjata! Hidhi sa më parë..!

Papritur, Hasani u ngrit dhe veçoi dy prej tyre, dhe i tha:

- Mos i hidh këto, nënë! Do të na duhen më vonë!

Babai i habitur e pyeti:

- E çfarë do të bësh me to?!..

Hasani u përgjigj:

- Kur të plakeni ju, do t'jua jap ushqimin në këto pjata plastike.

Prindërit e Hasanit u turpëruan dhe u ndjenë shumë në faj për atë që i kishin bërë gjyshit të tij. E ftuan atë të hante përsëri në një tryezë me ta.

Djali i marangozit plak dhe nusja e tij nuk do të silleshin ashtu, po ta dinin se gjëja më e mirë që e shpie njeriun në xhenet është mirësia ndaj nënës dhe babait.

Sa bukur ka thënë Pejgamberi ynë i Nderuar:

“Kënaqësia e Allahut fitohet duke kënaqur nënën e babain, ndërsa zemërimi i Allahut duke zemëruar nënën e babain.”

MIR SE ERDHE, SAMIU I VOGËL!

- Mami, shiko, po bie shi - tha Mehmeti.

E ëma iu afrua djalit. I buzëqeshi dhe nisi ta përkëdhelte.

- Po biri im, - tha ajo. Shiu është mëshirë dhe begati! Shih pemët, barin, lulet, si e shuajnë etjen për ujë.

Pastaj ata panë njëri-tjetrin. Teksa buzëqeshnin, djali vuri re në fytyrën e nënës paksa mërztije. S'arrinte ta kuptonte. Nëna psherëtiu me dhimbje. Djali u merakos dhe e pyeti:

- Nënë, je mirë?!

- Mirë jam, biri im! Mos u shqetëso! Eja tani, ulu të hash.

Pas këtyre fjalëve, i telefoni të shoqit dhe bisedoi diçka me të, të cilën Mehmeti nuk arriti ta kuptonte plotësisht. Megjithatë, ai arriti të mësonte nga ajo bisedë telefonike, se e ëma ishte e sëmurë dhe se duhej të shkonte në spital.

Më pas, erdhën njëherësh i ati dhe gjyshja e Mehmetit. E ëma iu afrua Mehmetit, e puthi në faqe dhe i tha:

- Shpirti im i vogël! Tani, unë, po shkoj në spital. Me ndihmën e Zotit, kur të kthehem, do të të sjell një vëlla, prandaj lutu për mua, mirë?

Mehmeti, për momentin, nuk arriti të thoshte gjë tjetër vetëm: "Mirë mami, mirë, në rregull!" E ndiente se donte të thoshte diçka, por... Ishte hera e parë që po provonte një ndjesi të tillë...

Gjyshja dhe Mehmeti i ndoqën që nga dritarja. Ai i përshëndeti me dorë nënën dhe babanë. I tha me vete të gjitha lutjet që dinte. Më pas, pa, se në dritare u afrua një zog i vogël. Fluturaku ishte i bukur, lozonjar dhe me pendë jeshile. Ai siç duket i kishte ikur shiut për të gjetur ngrohtësi në dritare.

Mehmeti i lëshoi një zë gjyshes. Ajo erdhi. Hapën dritaren dhe morën zogun. E futën brenda. Ishte e qartë se ky zog kishte ikur nga foleja e tij.

- Çfarë do bëjmë tani me këtë zog?! I kujt do jetë vallë?,- foli gjyshja.

Mehmeti nisi t'i lutej gjyshes duke i thënë:

- Aman, të lutem, le të qëndrojnë këtu! Do të kujdesem unë për të!

Gjyshja kishte mbetur e habitur dhe s'dinte ç'të thoshte.

- Nejse, le ta ushqejmë njëherë... Më pas të pyesim dhe komshinjtë, se mos është i ndonjërit, - tha ajo.

I dhanë ujë dhe thërime buke deri sa zogu u ngop. Zogu, nga gëzimi, nisi të fluturonte sa në njërën anë të dhomës, në tjetrën. Më pas erdhi dhe u ndal në supin Mehmetit. Dukej sikur vocërraku donte t'i tregonte diçka djalit...

Mehmeti thirri përsëri gjyshen.



- Gjyshe, i gjeta një emër zogut. Do ta quaj Pëtërxhëk. Si të duket? A nuk është i bukur?

- Prit njëherë, o nipçe! Akoma nuk është i yni. Pas pak do ta mësojmë se i kujt është..

Gjyshja fliste, ndërsa Mehmeti lutej herë pas here që, të mos gjendej i zoti i Pëtërxhëkut.

Kur shiu pushoi, gjyshja u nis për te komshinjtë për të pyetur se mos ndonjëri ishte i zoti i zogut. Pyeti e pyeti, por asnjëri nuk i doli për zot.

Kur gjyshja i tregoi, Mehmeti sa s'fluturoi nga gëzimi. Zogu, tashmë, ishte i tij. Për herë të parë ishte bërë me një zog.

Gjyshja kishte përfunduar namazin, kur ra zilia e telefonit. Ishte babai i Mehmetit. I dha lajmin e gëzueshëm. Mehmeti rrinte ende i habitur. Gjyshja i tha:

- Nipi im, gëzohu, u bërë me vëlla! Hajde, me jetë të gjatë! Edhe mami qenka mirë! Nesër do të vijnë...

Mehmeti ishte shumë kurioz për të vëllain. Vallë, i ngjante atij, apo ishte shumë lojçak? Kish-te shumë pyetje në kokë. Por njëra prej tyre ishte kjo: "Vallë, a do ta duan atë më shumë se unë?..."

Luajti me Pëtërxhëkun deri sa erdhi koha për të fjetur. Vërtet që lodhur. E zuri gjumi menjëherë. Në ëndërr pa të vëllain. Ai ishte shumë i ëmbël dhe i dashur. Vëllai i vogël veç i buzëqeshte Mehmetit.

Në mëngjes Mehmetin e zgjoi tringëllima i ziles. Me t'u ngritur ai, pranë i erdhi Pëtërxhëku. Si zakonisht i qëndroi mbi sup.

Mehmeti pa të hynte në dhomë nënën dhe të atin. Ky i fundit mbante në krahë foshnjën. Mehmeti shihte foshnjën në prehrin e të atit, ndërsa vetë i ati dhe e ëma shihnin zogun e vogël mbi supin e Mehmetit. U përqaftuan me njëri-tjetrin. Mehmeti pyeti për vëllain e vogël, kurse prindërit pyetën për mysafirin cicërues...

Mehmeti ishte habitur i tëri pas bebes. E shihte me shumë kujdes. Kurse foshnja kishte hapur sytë katër dhe shihte të vëllain. Më pas, bebja nisi të qeshte. Mehmeti e kuptoi se, bebja që kishte parë në ëndërr, nuk ishte askush tjetër, veçse i vëllai. Këtë ia tha menjëherë së ëmës. E ëma e përkëdheli.

- Shiko biri im,- vijoi ajo- vëllai na paska sjellë begati dhe mirësi në shtëpi. Ja, Pëtërxhëku është njëri prej tyre.

- Mami, si quhet vëllai? - pyeti Mehmeti nënën e tij.

- Sami e quajnë, - iu përgjigj ajo.

Mehmeti iu afrua të vëllait. Ai ishte shumë i këndshëm, por në të njëjtën kohë kuptoi se, ishte shumë i vogël. E puthi dhe më pas i tha:

- Mirë se erdhe, Samiu i vogël! Mirë se erdhe, vëllai im i shtrenjtë!





BISEDA:

GJYSH, NIPËR E MBESA

Të dashur fëmijë! Është një libër që nuk duhet ta shkëputni kurrë nga dora. Ky libër është Kurani.

Ermiri: O gjysh, po unë nuk di të lexoj Kuran.

Ibrahimi: Ndërsa unë nuk di asnjë lutje.

Gjyshi: Një fjalë e urtë thotë: “Nuk është turp të mos dish, por të mos mësosh.” Kësaj here ata që nuk dinë të lexojnë Kuran, do të mësojnë, ata që dinë do të përparojnë dhe të gjithë do të mësoni lutje inshallah, apo jo vogëlushët e mi të dashur?

Fëmijët: (një zëri) - Poooo!

Mejremja: I dashur gjysh! Përse është kaq e rëndësishme të lexosh Kuran?

Gjyshi: Kurani Kerim është mesazhi i Atij që na ka krijuar dhe na ka falur të gjitha të mirat. Për shembull, ti, Mejreme, a do të dëshiroje të mësoje se, përse dhe si të ka krijuar Allahu kaq të bukur dhe të ëmbël?

Mejremja: Sigurisht, që dëshiroj, gjysh i dashur.

Gjyshi: Po ti, Ermir, a dëshiron të dish se, përse Allahu i ka krijuar dhe na i ka falur gjithë këto fruta, perime dhe çdo mirësi tjetër?

Ermiri: - Po, gjysh i dashur, dua!

Dhurata: - Gjysh i dashur! Edhe unë dua të mësoj se si ta falënderojmë Allahun e Madhëruar.

Adbdulkერი: - Gjysh i dashur! Unë dua të mësoj se si të bëhem një mysliman i mirë.

Gjysh Nuriu: Fëmijë të dashur, të gjitha përgjigjet e këtyre pyetjeve ndodhen në Kuranin Kerim. Ja pra, për këtë arsye është shumë e rëndësishme që ta lexoni dhe ta kuptoni Kuranin. Të kuptosh mirë Kuranin Kerim është pak e vështirë, por leximin duhet ta mësoni patjetër. Për të kuptuar më mirë Kuranin Kerim duhet të lexoni dhe të mësoni ata që thonë dijetarët myslimanë.

Të dashur fëmijë, lexim të këndshëm të Kuranit!
Allahu ju ndihmoftë dhe ju dhëntë dituri!



MINITEST



1. Kush e ka thënë shprehjen: "Unë jam dërguar për të plotësuar virtytet e moralit"?

- a) Ademi (a.s.) b) Ibrahim (a.s.)
c) Muhammedi (a.s.) ç) Musai (a.s.)

2. Cila nga shprehjet e mëposhtme është "Fjala e teuhidit"?

- a) Allahu Ekber b) La ilahe il-lallah
c) Elhamdulillah ç) Subhanallah

3. Cila nga suret e mëposhtme përmban shprehjen "Zoti i botëve"?

- a) Surja el-Ihlas b) Surja el-Fatiha
c) Surja el-Keuther ç) Surja el-Fil

4. Profeti (a.s.) kujt ia diktonte për t'i shkruar ajetet që ia sillte Xhebraili (a.s.)?

- a) Bashkëshorteve të tij b) Melekëve
c) Shkruesve të shpalljes ç) Xhebrailit

5. Në sa vjet u plotësua zbritja e Kuranit famëlartë?

- a) 13 b) 23
c) 32 ç) 63

6. Cili nga katër librat e shenjtë i është shpalluar Isait (a.s.)?

- a) Zeburi b) Teurati
c) Ungjilli ç) Kurani

7. Cila nuk është prej arsyeve të zbritjes së librave hyjnorë?

- a) Njohja e Allahut.
b) Njohja e detyrave tona në këtë botë dhe gjetja e rrugës së drejtë.
c) Njohja e jetës së amshueshme pas vdekjes.
ç) Njohja e profesioneve të ndryshme.

8. Në cilën gjuhë është zbritur Kurani Kerim?

- a) Persisht b) Turqisht
c) Shqip ç) Arabisht

9. Çfarë mendimi duhet të ketë një mysliman në lidhje me librat hyjnorë që kanë zbritur para Kuranit Kerim?

- a) Duhet t'i besojë ata dhe të zbatojë urdhrat e Kuranit.
b) Duhet t'i zbatojë urdhrat e tyre dhe t'i besojë Kuranit.
c) Nuk duhet të besojë asnjë libër tjetër hyjnor përveç Kuranit.
ç) Asnjëra

10. Cila është detyra më e rëndësishme që kemi ndaj Kuranit?

- a) Të mësojmë leximin e tij në gjuhën Arabe.
b) Ta këndojmë për hir të të vdekurve.
c) Ta lexojmë shpesh, ta kuptojmë dhe të zbatojmë urdhrat e tij.
ç) Asnjëra

11. Kush është ai që për herë të parë e shumoi Kuranin dhe e dërgoi nëpër vende të ndryshme?

- a) Profeti Muhamed (a.s.).
b) Osmani (r.a.).
c) Ebu Bekri (r.a.).
ç) Omeri (r.a.).

(Përgjigjet do t'i gjeni në numrin e ardhshëm të revistës...)

PËRGJIGJET E NUMRIT TË KALUAR:

**1. C); 2. B); 3. C); 4. B); 5. B);
6. D); 7. A); 8. D); 9. C).**

Jeta e Omerit

PËRSHËNDETJE,
MIQTË E MI TË VEGJËL!
E DI SE PO E PRISNI
ME PADURIM PJESËN
TJETËR TË AVENTURËS
SË LUFTËTARIT TË
MIRËSISË. PRANDAJ
LE TË VAZHDOJMË PA
HUMBUR KOHË...

JOOO! MË HIPËN NERVAT TANI...
TË MIRËT PASKAN GJETUR NJË
LUFTËTAR TË MIRËSISË PËR
TË NA PENGUAR.



ZOTËRI, NA DUHET TA
ULIM ANIJEN
KOZMIKE NË NDOJË
MAL TË TOKËS,
PËRNDRYSHE TË MIRËT
DO TË NA KAPIN.

MIRË ATËHERË, LE TA
ZBRESIM ANIJEN NË
TOKË. NDËRKOHË DO TË
VËZHGOJ NË FSHEHTËSI
TË GJITHA VEPRIMET E
LUFTËTARIT TË MIRËSISË.



ATË MOMENT NË TOKË...
ME SA KUPTOVA,
TI DHE TË KËQIJTË
BËHENI TË PADUKSHËM,
NËSE DONI.



PO! ARSYEJA QË TË
KËQIJTË MUND TË TË
SHOHIN ËSHTË SE,
TASHMË, TI JE
NJË LUFTËTAR I
MIRËSISË.

NJË MINUTË!
TË MIRËT PO
KONTAKTOJNË
ME MUA.



PËRSHËNDETJE HOLI! DUAM QË TË NA
NJOHËSH ME LUFTËTARIN
E MIRËSISË.



SI
URDHËRONI,
ZOTËRI!

HOLI E ÇOI OMERIN NË NJË RRUGICË QË TË TAKOHET ME TË MIRËT.



OMER, TANI DO TË
NJIHESH ME TË MIRËT.

TUNGJATJETA,
OMER! UNË JAM POGILI, NDËRSA
KY ËSHTË JOGILI.

DOJA TË TË LAJMËROJA
SE ANIJA KOZMIKE E TË KËQIJVE
TASHMË KA ZBRITUR NË TOKË.
TË LUTEM, KI KUJDES!
KEMI SHUMË BESIM TEK TI.





Adelina Mamaqi



PËRRALLËZA E SHKRONJËS



Unë jam shkronja e nëntëmbëdhjetë e alfabetit.
Me mua fillojnë shumë fjalë. Por fjala më e bukur është:

Nëna

Njëherë Nora takoi një zanë dhe u shtang nga bukuria e saj. Zana buzëqeshi dhe e pyeti: - Vogëlushe, a ke parë tjetër më të bukur se unë?

- Ti je shumë e bukur, - ia ktheu Nora, por më e bukur se ti, është nëna ime.

Një herë tjetër, në një lëndinë plot lule, Nora pa një bletë që mblidhte nektar.

- Nuk u lodhe? - e pyeti.

- Jo, sepse unë jam punëtorja më e

madhe në botë.

- Gabohesh, - ia ktheu vajza, ti nuk ke njohur nënën time.

Një mëngjes maji, dielli hodhi një reze mbi jastëkun e Norës.

Rrezja e zgjoi dhe e pyeti:

- Vogëlushe, a ke parë reze më të ndritur se unë?

- E, si nuk kam parë? Sytë e nënës sime! - iu përgjigj Nora dhe, si një zog, u struk në krahët e nënës së shtrenjtë...

Fjalëurtat... për diturinë dhe mençurinë

- ◇ Lum ai që njeh vetveten.
- ◇ Kush nuk është i mësuar, s'di të urdhërojë.
- ◇ S'është marre të mos dish, por të mos duash të dish.
- ◇ E mirë dhe fuqia, po ca më e mirë urtia.
- ◇ Kush është i mençur, i plegëron punët vetë.
- ◇ Kush ka kokë, ka jetë.

Mblodhi: Kastriot Mahilaj

Prindërit

Pse lind fëmija
Me dy sy në ballë,
Dhe jo me tre, katër...
E kështu me rradhë?

Pse lind fëmija,
Me dy veshë,
Dhe jo me tre, katër...
Si numrat në rresht?

Pse lind fëmija
Me dy krahë,
Dhe jo me tre, katër...
Si degët në ah?

Pse lind fëmija
Me dy këmbë,
Dhe jo me tre, katër...
Porsi një rrënjë?

Krijuesi i Madh,
Nga "dy" i ka dhënë,
Se ka dy prindër,
Një babë, një nënë.

Hamdi Meça



Ardi katër vjeçar mori vesh, se i vëllai,
Dritani kishte ekskursion të nesërmen.

Po të nesërmen Ardi doli së bashku me
mamin e tij për të psonisur në pazar. Rrugës
takuan Bledin. Ai e pyeti:

- Ku po shkon, o Ardi?
- Po dal në ekskursion me mamin.



Ardi iu lut Dritanit, ngaqë ishte më i madh,
t'i tregonte një përrallë. Dritani nisi të
tregojë..., por dalëngadalë po e zinte gjumi.

- Nesër mbrëma do të tregoj dy përralla...,
- tha Dritani.
- ... por me sy hapur, - iu përgjigj Ardi.



Kamarieri afrohet dhe pyet klientin:

-Zotëri, doni t'ua ndaj picën në katër pjesë
apo në tetë?

-Ndaje në katër, pasi tetë pjesë s'mund t'i
ha..., - u përgjigj i qetë klienti.



Një nënë së bashku me
një fëmijë për dore, i afrohen
një kioske. Nëna i thotë
shitësit:

- Dua dy çokollata: një të
madhe e një të vogël.
- Këtë të voglën, e kuptoj që
e ke për vajzën, po këtë të
madhen për kë e ke..?!
- e pyeti shitësi.
- Për edukatoren...

Të njohim miqtë tanë, kafshët



QENI

-Ham, ham, ham! Ham, ham! - bërtas,
Se kështu unë di të flas.
Familiarët i thërras.
Edhe bishtin tund plot gaz.

Në oborr e në shtëpi,
Jam i butë si fëmi.
Kur më ngasin... O! Pastaj,
Mos të thonë se kam faj!





PINGUINI

Jeton në pol, Jug e Veri.
I veshur është si një zotni.
Këmishë të bardhë e frak të zi.
Sqepin e verdhë si me flori.

Në tokë kur ecën si bebe ngjan,
Si peshk, noton në oqean.
Nga njerëzit s'trembet, po nuk e nganë.
Dhe plot kureshtje, u vete pranë.

Është zog, po s'fluturon,
Pinguin emrin ia thonë.





MENDO PAK... E BUZËQESH

Ka folenë lart në male,
nuk i trembet syri kurrë;
është trime, guximtare,
vënë e kemi në flamur...

shqiponja

Ec si unë e ec si ti,
herë të bardha, herë gri,
kur zemërohen, sjellin shi...

retë



Sy verdhë e bisht fshesë,
ha kërpudha e lajthi,
ka shtëpizën lart në pemë,
pa më thoni, kush e di?

ketri



Vjeshtëza e artë
na i sjell dhuratë:
të kuqe, të ëmbla,
eh, sa ju ka ënda!

mollët



Kur dhelparakja i afrohet,
topthi bëhet menjëherë,
me gjembat vdekjeprurëse
e godet-o pandërprerë...

liriq!

Krimbat e kanë frikë,
pemët e kanë mik,
është mjek i pyllit
i thonë...

qumakapiku

NGJYROS



Fjalët e mëposhtme gjejini në tabelë në mënyrë horizontale, vertikale dhe diagonale.

O	A	U	L	R	B	J	N	U	H	K	I
J	U	N	U	S	D	E	T	U	L	V	B
T	S	F	M	K	M	P	S	E	R	N	R
D	I	U	E	N	U	A	I	C	B	A	A
N	J	S	D	K	I	S	M	A	I	L	H
T	M	U	A	H	V	U	L	B	A	S	I
H	E	J	Q	D	E	M	M	A	H	U	M



1. Adem
2. Nuh
3. Lut

4. Ibrahim
5. Jakup
6. Jusuf

7. Musa
8. Harun
9. Isa

10. Ismail
11. Muhammed
12. Junus

Cila nga fotot e vogla poshtë
mund të plotësojë foton e madhe?



Ndajeni tabelën në 4 pjesë të tilla që,
secila ndarje të ketë brenda: 1 Omer, 1
Holi, 1 të mirë dhe 1 të keq.





Gjeni 7 ndryshime mes dy fotove.

Plotësoni kutitë duke u bazuar tek figurat.

Unë kam humbur grupin e figurave gjeometrike. A më ndihmoni t'i gjej?

Ngjyra e katrorit tim ishte jeshile,
rrethi blu dhe katrori im ishte më i madh
se trekëndëshi.





I PASUR ËSHTË AI,
QË KA MË SHUMË
DITURI.

ALIU (R.A.)

MË I PASURI NE BOTE
ËSHTË AI QË DI EKONOMI,
NDËRSA MË I VARFËRI ËSHTË
KOPRRACI.

-CHAMFORT-

DO TË BËJMË DIÇKA
PËR NDESHJEN,
MOS E KENI
PROBLEM.

PËR TË SHPËTUAR
PREJ VESIT TË
NGRËNIES SË THONJVE,
SHKONI TE DENTISTI.

KË PO SHIKON
TI ORE....

NËSE DO TË KISHA KËTË
MENDJE QË KAM SOT, NË
SHKOLLËN FILLORE
DO TË ISHA MË I MIRI.

AS TEKNOLOGJIA NUK
GJETI NJË RRUGË
ZGJIDHJEJE PËR TABELËN
E SHUMËZIMIT.

BËHU MODEST, SI PEMA
ME FRUTA QË GJUJET
ME GURË.

A E
MËSOVE NOTIN?

GJATË GJITHË DIMRIT HËNGRA
GJITHË ATË PESHK, POR NUK E
MËSOVA QË NUK E MËSOVA NOTIN...

QABEJA

Qabeja pas Hz Ibrahimit është rindërtuar herë pas here. Një nga këto raste ka qenë edhe para shpalljes së profetësisë të Pejgamberit (a.s.).



Pejgamberi ynë, atëherë ishte tridhjetë e pesë vjeç. Shiu dhe rreshetet e ujërave i kishin dobësuar mjaft muret e Qabes. Mekasit vendosën t'i shembnin muret dhe t'i ndërtonin sërish.



Pas shembjes së mureve, çdo fis nisi të ndërtonte pjesën që i takonte.



Muret u ngritën. Kur erdhi radha të vendosej në vendin e vet Haxheru'l esved, nisi një debat i ashpër mes fiseve. Çdo fis e shihte veten më të privilegjuar për këtë punë me kaq nder.



Teksa po shtohet tensioni i debatit, një i moshuar propozoi që të pranohej si gjyqtar, ai që do vinte i pari në Qabe. Erdhi Pejgamberi (a.s.). Ata kërkuan që ai të ishte gjyqtar për ta.



Pejgamberi (a.s.) e kuptoi menjëherë situatën që ndodheshin fiset. Kërkoj një mbulesë. Mbi të vendosi Haxheru'l esvedin. Pastaj kërkoj një njeri për çdo fis të mbante mbulesën te secili cep. Më pas, me duart e tij të bekuara e vendosi gurin në vend.



Çdo njeri mbeti i kënaqur nga ky vendim. Fiset u paqëtuan dhe u përqafuan me njëri-tjetrin.

së
shpejti

